

INDEKSI I ÇMIMEVE TË IMPORTIT


T2 - 2026

Në tremujorin e dytë të vitit 2026, Indeksi i Çmimeve të Importit arriti 107,5 (2021 = 100). Krahasuar me tremujorin e dytë 2025, indeksi shënoi ulje me 0,1 %. Një vit më parë ky ndryshim ishte -0,7 %.

Krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë, çmimet e importit shënuan ulje në seksionet "Energjia elektrike, gaz, avulli dhe ajri i kondicionuar" (-2,2 %), "Industri nxjerrëse" (-0,2 %) dhe "Industria përpunuese" (-0,02 %).

Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2026, Indeksi i Çmimeve të Importit mbeti pothuajse i pandryshuar, me një rritje prej vetëm 0,001 %.

FIG. 1 NDRYSHIMET VJETORE TË INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË IMPORTIT SIPAS TREMUJORËVE



Shënim për përdoruesit:

- Të dhënat e detajuara janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Indeksi i Çmimeve të Importit](#)
- Në zbatim të Politikës së Trajtimin të Gabimeve, INSTAT ndërmerr pa vonesë korrigjimin e çdo gabimi të identifikuar në statistikën zyrtare të publikuara. Përdoruesit informohen në mënyrë të menjëhershme dhe transparente për korrigjimet dhe ndryshimet e reflektuara, në përputhje me parimet e paanshmërisë, transparencës dhe cilësisë së statistikave zyrtare. Politika e plotë e Trajtimin të Gabimeve është e disponueshme në adresën: <https://www.instat.gov.al/media/9577/politika-e-trajtimin-te-gabimeve.pdf>

Metodologjia

Indeksi i Çmimeve të Importit mat ecurinë e çmimeve të transaksioneve të produkteve industriale të importuara për tu shitur në tregun vendas,

INSTAT llogarit dhe publikon:

Indeksin e Çmimeve të Importit

Ndryshimet tremujore dhe vjetore të indeksit

Fusha e mbulimit:

Seksioni B - Industri Nxjerrëse

Seksioni C – Industri Përpunuese

Seksioni D - Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar

Seksioni E - Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit

Llogaritja e indeksit

Indekset llogariten për çdo produkt të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Produkteve (NP 2008) në nivel 6-shifror dhe publikohen sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE rev.2) në nivel 2-shifror. Duke filluar nga tremujori i parë 2024 e në vazhdim Indeksi i Çmimeve të Importit ka si periudhë referuese vitin 2021 = 100. Metoda e llogaritjes së indeksit është metoda zinxhir (Laspeyres - chain index) sipas së cilës, çmimi i produktit në periudhën korente (y) krahasohet me çmimin e muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm (y – 1).

Për llogaritjen e indeksit përdoret formula si më poshtë:

$$I_{korrent}^{y,m} = \frac{100}{\frac{1}{12} \sum^{Dec} I_{Y-1,Dec}^{Y,M}} + \prod_{Y=viti \text{ bazë}}^{y-1} I_{Y-1,Dec}^{Y,M} * I_{y-1,Dec}^{y,m}$$

- Pjesa e parë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve të muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm krahasuar me mesataren e çmimeve në vitin bazë.
- Pjesa e dytë e formulës tregon lëvizjen zinxhir të indeksit të çmimeve nga muaji Dhjetor të vitit të mëparshëm deri në periudhën y-1.
- Pjesa e tretë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve nga muaji Dhjetor y-1 në muajin m të vitit y.

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korrent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve vjetore në nivelet e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të çdo tremujori.

Ndryshimi tremujor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korrent dhe tremujorit të mëparshëm.